



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Në bazë të autorizimeve të dhëna me neni 10 paragrafi 3 të Ligjit nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, nenin 37.2 nën paragrafi (c), nenin 65.2 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe nenin 5, 6 dhe 7 të Udhëzimit Administrativ për Zëvendësimin e Anëtarit të Kuvendit Komunal, Nr.01/2017, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, më 21.12.2020, nxjerr këtë:



V E N D I M

- I. **Z.BAHRI BLAKQORI** emërohet anëtar i Kuvendit Komunal në Podujevë, nga subjekti politik “Lidhja Demokratike e Kosovës-LDK” duke e zëvendësuar anëtarin e Kuvendit Komunal z.Avni Fetahu.
- II. Obligohet Sekretariati i KQZ-së, që ky vendim t’i komunikohet z.Bahri Blakqori dhe të ndërmerren veprimet procedurale për zbatim.

Arsyetim

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka shqyrtuar shkresat e lëndës të dorëzuara në KQZ më datën 14.02.2020, Nr.1352/2020, për zëvendësimin e anëtarit të Kuvendit Komunal zAvni Fetahu, pas dorëheqjes së përvokueshme për arsye të zgjedhjes në pozitën e drejtorit për arsim në Podujevë.

Pas shqyrtimit të kërkesës dhe shkresave të bashkangjitura, është verifikuar dhe konstatuar, se kandidati i radhës në listën e rirenditur është, z.Bahri Blakqori i cili ka dhënë deklaratën e pranimit të mandatit si kandidat i radhës, nga i njëjti subjekt politik, i gjinisë së njëjtë dhe me numër më të madh të votave, sipas rezultateve të certifikuar të zgjedhjeve lokale të vitit 2017, dhe pas plotësimit të të gjitha kushteve ligjore, KQZ-ja vendosi si në pikën I të këtij vendimi.

- III. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 21.12.2020

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve


Valdete Daka

